

Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, ASA, Tiranë, në bashkëpunim me Departamentin e Antropologjisë, Fakulteti i Filozofisë, Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë, organizojnë simpoziumin shkencor:

"Perspektiva studimore mbi Kosovën"
20-21 dhjetor 2019



Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit
Akademia e Studimeve Albanologjike
Rruga Naim Frashëri Nr. 1
Tiranë

DITA E PARË

20 dhjetor 2019

10:30-12:00. "**Kosova n'sy e n'dorë të etnografit**"- Ekspozitë fotografike dhe etnografike

Ekspozita etnografike

Dëshmi të kulturës materiale të Kosovës në Shqipëri

Kuratorë: Afërdita Onuzi dhe Ermela Broci me ndihmën e punonjëseve Vilma Nallbani, Migena Dukagjini.

[Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit]

Në kuadër të 20-vjetorit të eksodit të Kosovës (1999-2019), Departamenti i Etnologjisë, pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit sjell ekspozitën *Dëshmi të kulturës materiale të Kosovës në Shqipëri*. Përmes kësaj ekspozite do të njihemi me disa prej punimeve artizanale të Kosovës të kultivuara në qytete dhe rrethinat e saj, që sot janë pjesë e fondit etnografik në IAKSA-së. Për t'u ekspozuar janë përzgjedhur punimet më me vlerë në dru, metal, argjendari dhe tekstil, si: qëndisje me fije ari, veshje kombëtare, breza të zbukuruar, jelekë, enë bakri, vegla shtëpiake që paraqesin vetëm një pjesë të vogël të koleksionit etnografik të Kosovës që gjenden në fondet etnografike të IAKSA-së.

Në këtë ekspozitë, Prof. Afërdita Onuzi, (ndër të parët që u angazhua në mbledhjen e këtyre artefakteve), do të sjellë vëmendjen jo në teknikat dhe mënyrën e punimit të këtyre artefakteve, por në praktikën e vendosjes së tyre në fonde si dhe mënyrën se si këto artefakte erdhën dhe janë sot pjesë e fondit etnografik të IAKSA-së. Kjo është arsyeja pse këtë ekspozitë e kemi quajtur: *Dëshmi të kulturës materiale të Kosovës në Shqipëri*.

Kjo ekspozitë, me rëndësi për Kosovën dhe më gjerë, është **vetëm një pjesë e pasurisë tradicionale të krijuar gjatë një procesi të gjatë të zhvillimit kulturor dhe është dëshmi e pasurisë dhe diversitetit të traditës popullore të Kosovës.**

Ekspozita fotografike

Exodus": Kosova n'sy të etnografit

Kurator: Olsi Lelaj

[Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit]

Në korrik të vitit 1999, Instituti i Kulturës Popullore (IKP) të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ndërmori një ekspeditë studimore në fokus të së cilës ishin refugjatët kosovarë të vendosur në kampet e pritjes të ngritura në Tiranë dhe Durrës. Bashkë me etnografët dhe folkloristët e IKP-së, në këtë ekspeditë morën pjesë edhe disa studiues të folklorit dhe etnografisë nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Kjo ekspeditë nuk ishte e vetmja, pasi gjurmime etnografike dhe folklorike u bënë edhe mes refugjatëve kosovarë në Kukës. Përveç shënimeve në blloqet e punës dhe intervistave të thelluara, grupet e punës përdorën gjerësisht

aparatin fotografik dhe kamerën filmike për të dokumentuar vizualisht refugjatët në Shqipëri si dhe kthimin e tyre në Kosovë. Fatkeqësisht, në Arkivin e Fototekës së Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, prej kësaj ekspedite janë depozituar vetëm 2 filma negativë, në total 48 poza. Autorë të fotografive janë Gjergj Martini dhe Nikolin Baba, fotografë të Institutit të Kulturës Popullore, të cilët ndihmuan studiuesit në punën e tyre të terrenit. Fati i fotografive të tjera nuk dihet ende plotësisht. Fotografitë që ekspozohen këtu janë zhvilluar pikërisht prej negativëve të kësaj ekspedite që ruhen sot në fototekën e IAKSA-së. Këto fotografi na japin mundësinë për të diskutuar mbi një numër të gjerë çështjesh, të cilat shqetësojnë etnografinë dhe antropologjinë shqiptare. Mbi të gjitha imazhet para nesh kërkojnë dhe na apelojnë të reflektojnë mbi raportin që ka dija etnologjike shqiptare me të “tashmen”, veçanërisht kur kjo e fundit merr përmasa të jashtëzakonshme.

REFERATE

Pikëpamje mbi Kosovën [Salla “Rrok Zojzi”]

12:00. Fjala e hapjes

Paneli I

Moderator: Ervin Kaçiu

12:15-13:15. Lumnije Kadriu

[Dega e Etnologjisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës]

Familja trans-tradicionale si rrjedhojë e trendeve transnacionale

Për shumë studiues të shkencave shoqërore e humane analizimi i organizimit të familjes ishte kyç për kuptimin e komuniteteve shoqërore dhe kulturës së tyre. Në Ballkan më e shquara ishte e ashtuquajtura familje e madhe patriarkale (tradicionale), në të cilën jetonin të paktën tri gjenerata. Gjatë viteve ‘60, etnologu Mark Krasniqi dalloi disa varietete të saj në Kosovë, ndër të cilat numëron edhe këto: familje përkohësisht të ndara; familje të përhershme ose të palëvizshme; familje me profesione të përziera (bujqësi-nëpunësi-industri etj). Duke marrë parasysh numrin e madh të migrantëve nga Kosova që lëvizën në periudha të ndryshme, sot familjet transnacionale ndër shqiptarët e Kosovës janë një fenomen i zakonshëm. Deborah Fahy Bryceson dhe Ulla Vuorela i definojnë si familje transnacionale “familjet që jetojnë ca kohë apo të shumtën e kohës të ndara nga njëra tjetra, megjithatë ato mbahen së bashku dhe krijojnë diçka që mund të shihet si mirëqenie kolektive dhe unitet, d.m.th. ‘familjari’, madje edhe përtej kufijve”. Për të kuptuar më mirë praktikën në familjet e tilla, si dhe kontekstet të cilat njëkohësisht përfshijnë edhe çështjet e identitetit, në këtë referat do të jepen përgjigje për disa pyetje, si: Cilat elemente tradicionale janë ruajtur? Çfarë ndikon në ruajtjen e tyre? Cilat janë ndryshimet që kanë ndodhur?

Rezultatet e hulumtimit janë bazuar në të gjeturat empirike përmes vëzhgimit me pjesëmarrje dhe bashkëbisedimeve me disa familje transnacionale. Si mbështetje teorike janë

përdorur hulumtimet në studimet transnacionale, ndërsa si mjet analize është përdorur edhe kategorizimi i sipërpërmendur i Krasniqit, që, si dëshmi e pranisë së fleksibilitetit në familjet e mëdha të shqiptarëve të Kosovës, vjen shumë i përshtatshëm për të kuptuar vazhdimësinë e karakteristikave të shumta të saj në familjet e sotme transnacionale.

13:15-14:15. Arsim Canolli

[Departamenti i Antropologjisë, Universiteti i Prishtinës]

Prej bukës te shteti: antropologji e Kosovës

Në prezantimin tim do të flas për studimet e mia të deritanishme mbi kulturën e bukës dhe ndryshimet shoqërore në shoqërinë e sotme kosovare. Pastaj do të diskutoj edhe për tregimin muzeor të Kosovës në kontekst të studimeve mbi muzeun, kulturën dhe narracionin identitar. Pastaj, do të diskutoj mbi festën dhe festivitetin, duke marrë për bazë studimin e festivaleve folklorike, si festa dhe përkujtime, si akte të legjitimitetit kulturor dhe politik. Do të flas për këto aspekte në kontekst të trashëgimit, transformimit dhe negocimit në rrafshin social e kulturor në Kosovë, si shoqëri e artikuluar në kontekst të shtetit të ri të Kosovës, por edhe në kontekst të kombit shqiptar policentrik. Në fund, do të hedh në tavolinë një skicë konceptuale mes antropologjisë dhe historiografisë, që del nga reflektimet e fundit mbi kujtesën dhe oralitetin, si objekte të studimit antropologjik dhe historiografik. Përmes prezantimit të këtyre akteve hulumtuese, dua të diskutoj për qasjen dhe perspektivën teorike në kuadër të kërkimeve të mia dhe motivet e sprovës për një antropologji të trashëgimisë kulturore.

14:30-16:30. **Dreka**

Paneli II

Moderatore: Blerina Hankollari

16:30-17:30. Shemsi Krasniqi

[Departamenti i Sociologjisë, Universiteti i Prishtinës]

Ndjesia për natyrën, trashëgimia dhe kujtesa për luftën në Kosovë

Referati im përmbledh punën shumëvjeçare në dy projekte kërkimore, të cilët dallojnë shumë mes tyre, por emërues i tyre i përbashkët mund të themi se është kujtesa kolektive. I pari ka të bëjë me ekokulturën dhe ka qenë ide qendrore e tezës sime të doktoratës dhe është titull, po ashtu, qendror i librit tim të botuar nga ASHAK në vitin 2016. Kjo ka të bëjë me elementet që ka krijuar kultura jonë popullore në raport me natyrën, elemente këto të cilat nuk janë vetëm vlera, koncepte dhe parime, por janë edhe sjellje dhe praktika të rëndësishme sociale. Pjesë e këtij projekti është edhe studimi i artit shkëmbor të Kosovës. Arti shkëmbor, në fakt, është fushë më vete, por e kam integruar me ekokulturën, në kuptimin se edhe simbolet e gravuara në gurë, ose petroglifet e ndryshme, pasqyrojnë lidhjen e vazhdueshme të kulturës me natyrën. Për më tepër, arti shkëmbor është një kujtesë e fjetur e njerëzimit, e cila duhet të evidentohet, deshifrohet, interpretohet dhe promovohet si trashëgimi e rëndësishme. Qasja metodologjike në projektin

“Ekokultura” është bukur komplekse, ndërsa pjesë e këtij kompleksiteti është edhe metodologjia vizuale dhe si derivacion i kësaj ka dalë edhe ideja “Arterren”, e që do të thotë se gjatë punës empirike në terren, mund të bëhen edhe fotografi artistike.

Projekti i dytë ka të bëjë me mënyrën si kujtohet lufta, përkatësisht eksodi i dhunshëm i vitit 1999, ku mbi një milion kosovarë u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Projektin e kam quajtur “Kujtesa përballë harresës” dhe ka të bëjë me një kërkim cilësor që realizohet në çdo pesë vjet. Herën e parë është bërë në vitin 2009, me rastin e 10-vjetorit, herën e dytë më 2014, kurse herën e tretë më 2019, pra me rastin e 20-vjetorit të eksodit kosovar. Të dhënat janë mbledhur me metodën e intervistës së thellë dhe diskutimeve në fokus grup, kurse çështjet për të cilat është biseduar me informantët janë përshkrimi i rrethanave para ikjes nga shtëpia, dita e ikjes, përvojat e ecjes në kolonë, jeta si refugjat dhe kthimi në Kosovën e lirë. Në fund janë edhe vlerësimet për jetën aktuale në Kosovë. Baza e të dhënave të këtij projekti arrin në rreth dy mijë faqe material dhe pritet të botohet si libër, por edhe të ruhet si material arkivor në Arkivin e Kosovës, Bibliotekën Kombëtare etj.

17:30-18:30. Arben Hajdari

[**Departamenti i Antropologjisë, Universiteti i Prishtinës**]

Transformimi i vendbanimeve në Dardani gjatë antikitetit të vonë-mesjetës së hershme përballë kërcënimit barbar

Kriza e gjithmbarshme që përfshiu Perandorinë Romake gjatë antikitetit të vonë u reflektua me ndryshime të shumta në gjithë territorin e saj. Përballë këtyre ndryshimeve, që u provokuan, në mes tjerash, edhe nga kërcënimi i fiseve barbare, u vu natyrshëm edhe provinca e Dardanisë. Në kuadër të kësaj eseje, nga tërësia e ndryshimeve që e karakterizuan këtë periudhë, do të merret në shqyrtim vetëm aspekti urbanistik, përkatësisht transformimi i vendbanimeve, parë përmes dy prej tyre e që ishin më karakteristike të kësaj periudhe, Ulpiana dhe Harilaqi. Kurse, sa i përket shtrirjes gjeografike, analiza fokusohet vetëm në hapësirën e Dardanisë që sot zë territori i Kosovës.

20.00. **Darka**

DITA E DYTË

21 dhjetor 2019

Paneli III

Moderatore: Mikaela Minga

10:00-11:00. Eli Krasniqi

[Instituti e Historisë (Historia dhe Antropologjia e Evropës Juglindore - HAEG),
Universiteti e Grazit, Austri]

Familja dhe Patriarkalizmi në Kosovë: ndryshimet dhe vazhdimësitë nga mesi i shekullit 20 deri në fillim të shekullit 21

Ky prezantim do të paraqesë vazhdimësitë dhe ndryshimet në familje dhe në sistemin patriarkal në Kosovë nga pas-Lufta e Dytë Botërore deri në ditët e sotme, duke pasur si rast studimi rajonin e Opojës, por edhe Prishtinën si kryeqytet. Prezantimi, duke qenë që është hulumtimi i doktoraturës (2018), do të shpalosë materialin kërkimor dhe tezat kryesore të këtij kërkimi, duke u përqendruar në kapitujt kryesor të disertacionit: a) Ndryshimet në familje - numri i anëtarëve, ndarja e pronës etj; b) Identiteti fisnor dhe gjenealogjitë familjare - identiteti fisnor në Opojë, mungesa e elementeve kanunore dhe politikat identitare; c) Sistemi patriarkal - gratë në modernitetin socialist jugosllav dhe në periudhën e pasluftës së 1999 në Kosovë; d) Martesat dhe Migracioni i Punës; e) Siguria sociale – kriza e kujdesit dhe riprodhimi shoqëror. Kjo paraqitje, ndër tjera, synon që të ngrejë pyetje mbi atë se si matet ndryshimi shoqëror? Cilat janë pikat e vështrimit që e kushtëzojnë njohjen e ndryshimeve si të tilla?

11:00-12: 00. Nebi Bardhoshi

[Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë].

Antropologjia, kufiri, prona

Kjo fjalë do të paraqesë në mënyrë të përmbledhur punën e kryer në zonën kufitare Shqipëri-Kosovë nga viti 2002 e në vijim. Qëllimi kryesor është përmbledhja e të dhënave dhe rishikimi i punës së deritanishme mbi ligjin, shoqërinë dhe shtetin në një zonë kufitare. Paraqitja e të dhënave do të ndjekë një sens kronologjik, duke pasur si qëllim reflektimin mbi punën e realizuar, e bashkë me këtë do të nënvizohen shtigjet teorike nëpër të cilat u zhvilluan projektet kërkimore. Vëmendja më specifike do t'i kushtohet raportit të marrëdhënieve të pronësisë, se si këto marrëdhënie u zhvilluan në mes sistemeve të ndryshme ligjore e politike në një zonë kufitare, duke shqyrtuar, në njërin anë, zhvillimin e së drejtës përkundrejt kulturës dhe narrativave legjitimuese e, në anën tjetër, raportin në mes së drejtës dhe institucioneve që do të kishin për qëllim aplikimin e së drejtës. Në fund do të theksohen projektet e tjera kërkimore dhe sprovat antropologjike në proceset e “profanizimit” të së drejtës zakonore dhe asaj shtetërore, kushtin politik të të jetuarit “nëpër faza kalimtare” të një shoqërie të ikjes dhe shtetit që braktis, përkundrejt një shteti që kërkonte të ndërtonte njeriun dhe shoqërinë e re.

12:00-14:00. **Dreka**

14:00-15:00 Linda Gusia

[Departamenti i Sociologjisë, Universiteti i Prishtinës]

Kujtesa e shtëpive-shkolla në Kosovë, rimediatizimi dhe digjitalizimi

Qëllimi fillestar i këtij studimi është reflektimi rreth politikave të kujtesës me fokus në sistemin arsimor të viteve '90 në Kosovë. Ky studim shpalos mënyrat e ndryshme, përmes të cilave të rinjtë, të cilët nuk kanë kujtesë personale të viteve '90, bashkëveprojnë me kujtesën digjitale. Duke hulumtuar së bashku me studentët procesin e ndërtimit të Muzeut të Shtëpive Shkolla në Prishtinë, në përpjekje të dokumentimit arkivimit, intervistave dhe digjitalizimit me anë të hulumtimit me pjesëmarrje dhe veprim, hulumtimi ngre pyetjet e mediatizimit të kujtesës. Për më tutje, synon reflektim mbi metodën e pjesëmarrjes me veprim dhe bashkëprodhimet gjatë procesit të hulumtimit. Krijimi i webfaqes dhe filmit dokumentar gjatë këtij hulumtimi nuk ka vetëm qëllim të ofrimit të dukshmërisë për temat më pak të trajtuara, por, në veçanti, reflektimin mbi konstruktimin dhe reprezentimin e ngjarjeve historike dhe diskurseve të krijuara. Kjo qasje nënkupton edhe reflektimin mbi vendosjen time në relacion me temën, kujtesën dhe përvojat personale mbi periudhat dhe temat që trajtoj. Pozita ime si hulumtuese e përafërt me ngjarjet që i hulumtoj përmban implikime të caktuara politike të lokacionit dhe ngre pyetjet e hulumtimeve të prodhuara nga ata që Rothberg quan “subjekte të implikuara”.

Workshop

“Pamje nga Kosova” [Salla “Rrok Zojzi”]

Moderatore: Ermela Broci

15:15-16:15. Durim Abdullahu

[Departamenti i Antropologjisë, Prishtinë]

Dokumentar: **“Lufta e Kosovës: rrëfyer nga gazetarët”**

"Lufta e Kosovës e rrëfyer nga gazetarët" është një dokumentar televiziv, prodhim i KTV-së (Kohavision-it) i vitit 2016, me autor Durim Abdullahun. Ai është i gjatë 39 minuta dhe është ndërtuar përmes një narracioni minimalist, që lidh rrëfimet e 7 gazetarëve dhe operatorëve medialë shqiptarë, që kanë mbuluar ngjarje gjatë luftës së Kosovës (1997 - 1999) për media të ndryshme, si: *Associated Press*, *Reuters* dhe *Koha Ditore*. Duke qenë gazetarë, si një palë neutrale dhe e ndërmjetme, si dëshmitarë krejt unikë, personazhet e këtij dokumentari rrëfejnë çfarë kanë parë dhe përjetuar gjatë punës së tyre në periudhën e luftës së viteve '97 - '99, të bërë prej Serbisë në Kosovë, si e fundit prej luftërave të Jugosllavisë. Në këtë dokumentar ata tregojnë përvojat e tyre në disa prej historive kryesore të luftës, si: masakra e Prekazit, masakra e Abrisë, e Reçakut, e Rogovës së Hasit dhe histori të tjera të kësaj lufte. Këto histori personale

lufte, janë të mbuluara vizualisht me dhjetëra fotografi dhe pamje arkivore të vetë personazheve të këtij dokumentari apo të ekipeve të tyre, duke e plotësuar kështu një panoramë narrative dhe vizuale të përputhshme mes tyre për realitetin e luftës së viteve 1997 - 1999 në Kosovë.

16:15-16:30. **Pushim kafeje**

16:30- 17:00. Zanita Halimi

[Departamenti i Antropologjisë, Prishtinë]

Fotografia familjare si reflektim i konteksteve shoqërore

Fotografia paraqet “inventarin kulturor”, pra jo vetëm kulturën materiale të dukshme në të, por edhe marrëdhëniet mes njerëzve, të dukshëm e padukshëm në të. Siç thekson Collier “Inventari fotografik mund të regjistrojë jo vetëm gamën e objekteve në një shtëpi, por edhe marrëdhëniet e tyre me njëri –tjetrin, stilin e vendosjes së tyre në hapësirë, të gjitha aspektet që përcaktojnë dhe shprehin mënyrën në të cilën njerëzit përdorin hapësirën dhe pronësitë e tyre”.

Fotografitë familjare në Kosovë, shikuar nga aspekti historik, fillimisht janë bërë në studiot e fotografive nga fotografë, të cilët kanë mbaruar shkollën për fotografi jashtë Kosovës, si në: Selanik, Itali, Turqi etj. Në fillim familjet që janë fotografuar në studiot e fotografive ishin të pakta; ato ishin kryesisht familje të pasura. Gradualisht, numri i poseduesve të aparateve fotografike personale u rrit dhe kështu ndryshoi edhe mënyra, vendi dhe ngjarjet e fotografimit.

Duke qenë se për Kosovarët koncepti i familjes është shumë domethënës, ky prezantim do të përqendrohet në fotografitë familjare. Ato do të trajtohen jo vetëm si artefakt kulturor, por edhe si pasqyrim i kontekstit historik, social dhe kulturor. Prandaj, përmes mënyrës se si trajtohen fotografitë brenda familjes, do të analizohet struktura e familjes organizimi i saj, ngjarjet më të rëndësishme të saj, prania dhe mungesa e anëtarëve të familjes, rregullimi i tyre (fotografive) brenda hapësirave të ndryshme të shtëpisë. Përmes fotografive jo vetëm që pasqyrohen marrëdhëniet brenda anëtarëve të familjes, por pasqyrohen edhe lidhjet familjare me nivele të tjera sociale, kulturore dhe politike.

17:00-17:30. Olsi Lelaj

[Instituti i Antropologjisë kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë]

T’parit nëpërmjet Kosovës

Në fokus të këtij prezantimi është Laboratori i Antropologjisë Vizuale që zhvillohet prej katër vitesh në festivalin ndërkombëtar të filmit dokumentar *Dokufest* në Prizren. Diskutimi, ndërsa përmbledh punën dhe aktivitetet e zhvilluara në punëtoritë e L.A.V-it, reflekton se si terreni në zonën kufitare mes Shqipërisë dhe Kosovës është kthyer në një arenë të rëndësishme: a) në debatin mbi disa tema kyç të teorisë antropologjike, b) në zhvillimin e dijen kritikore-reflektive dhe c) të bashkëpunimit ndërinstitucional në antropologjinë shqiptare.

17:30. **Konkluzione**

Mbyllja e punimeve të konferencës